

EPPC Kosovo kërkon një **Menaxher të Shitjes**, për klientin e saj, kompani shumë e njohur në **industrinë e menaxhimit të patundshmërive**.

Përgjegjësitë kryesore:

- Mbikëqyr dhe menaxhon të gjitha aktivitetet e para-shitjes, shitjes dhe pas shitjes.
- Mirëmban në mënyrë të vazhdueshme marrëdhëniet me klientët.
- Zhvillon planet e nevojshme për përgatitjen e buxhetit të shitjeve.
- Zbaton planet e marketingut për tregjet e synuara në përputhje me strategjitë e miratuara të kompanisë.
- Zbaton strategjitë e depërtimit dhe shitjes në tregjet e synuara.
- Përgatit kontratat dhe siguron përditësimin e vazhdueshëm të informacionit mbi shitjet.
- Koordinon mbledhjen e pagesave nga klientët në përputhje me kushtet e kontratës.
- Menaxhon marrëdhëniet me agjencitë e patundshmërive dhe partnerët e tjerë.
- Kryen hulumtime të tregut në industrinë e patundshmërive sipas nevojave të brendshme.
- Përgatit dhe siguron dokumentacionin e kërkuar për prezantimin e projekteve dhe pronave të kompanisë.
- Përgatit raporte dhe analiza mbi situatën e shitjeve në kompani dhe i prezanton ato te menaxhmenti.
- Bashkëpunon në mënyrë efektive me anëtarët e ekipit, për të adresuar problemet dhe sfidat e shitjeve.
- Kryen detyra të tjera sipas kërkesave dhe nevojave.

Kërkesat për këtë pozicion janë:

- Të ketë të përfunduar studimet universitare.
- Të ketë përvojë së paku 3 vjeçare në menaxhim të shitjeve (përvoja në patundshmëri paraqet avantazh).
- Të ketë njohuri të mira të gjuhës angleze.
- Të ketë aftësi të forta organizuese dhe koordinuese.
- Të ketë aftësi të forta bindëse dhe negociuese.
- Të ketë njohuri në përdorimin e pakos MS Office dhe programit Autocad (read).
- Të jetë kreativ/e dhe me aftësi të theksuara analitike dhe prezantuese.
- Të jetë i/e saktë, i/e vetorganizuar dhe të ndërmarrë iniciativa të reja.
- Të posedojë patentë shoferin.

Të dhënat:

Pozicioni:	Menaxher i Shitjes.
Lokacioni:	Prishtinë, Kosovë.
Paga:	Konkurruese.
Kontrata:	Sipas ligjit të punës.
Aplikimet mbyllen më:	29.10.2023.

Si të aplikoni:

Për të aplikuar për këtë mundësi punësimi, ju lutemi dërgoni CV-në tuaj dhe dokumentet e tjera shoqëruese duke përmendur në *subject* pozicionin '**Menaxher i Shitjes**' në adresën e e-mail^{it} kosovo@eppc.al.

Ju do të kontaktoheni vetëm në qoftë se CV-ja juaj dhe dokumentet shoqëruese do të kualifikohen tutje. Te ne CV-ja juaj është e sigurt dhe trajtohet në konfidencialitet të plotë.